



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALESI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 1898/2 Prot.

Koplik, më: 28/06/2022

V E N D I M

Nr 22 Datë 27 / 06 / 2022

PËR

**“PJESËMARRJEN E BASHKISË MALËSI E MADHE NË SUBJEKTE ME  
KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË  
FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE  
TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e datës 27.06.2022. Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar nenit 14 e vijues, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të VKM nr.302, date 11.05.2022 “Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe te largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e Autorizimit për Kryetarin e Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, për të negociuar me Bashkitë e Qarkut Shkoder si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë e lidhjes së marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit sipas VKM nr. 302, date 11.05.2022 “Për politikat kombetare për riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe të largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “Ujesjelles Kanalizime ” sh.a Malësi e Madhe , që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia Malësi e Madhe do të jetë aksionare, dhe të vijoje më miratimin në Asamblene e Pergjithshme të Aksionareve të autorizimin për Administratorit e shoqërisë aksionare “Ujesjelles - Kanalizime Malësi e Madhe” sh.a për nenshkrimin e çdo akti të nevojshem kontraktore dhe noterial me qellim transferimit të veprimtarisë ekonomike për të shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,

KRYETAR  
Ilir Halaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALESI E MADHE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË ASETJEVE  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1848/Prot.

Koplik ,më: 20/06/2022

**PROJEKT - V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_ Datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2022

**PËR**

**“PJESËMARRJEN E BASHKISË MALËSI E MADHE NË SUBJEKTE ME  
KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË  
FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE  
TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar nenit 14 e vijues, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, të VKM nr.302, date 11.05.2022 “Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe te largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”,

**PROPOZOJ :**

1- Miratimin e Autorizimit për Kryetarin e Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, për të negociuar me Bashkitë e Qarkut Shkoder si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë e lidhjes së marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit sipas VKM nr. 302, date 11.05.2022 “Per politikat kombetare per riorganizimin e sektorit te furnizimit me uje dhe te largimit, trajtimit dhe perpunimit te ujrave te ndotura”.

2- Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “Ujesjelles Kanalizime ” sh.a Malësi e Madhe , qe pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia Malësi e Madhe do të jetë aksionare, dhe të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorit e shoqërisë aksionare “Ujesjelles - Kanalizime Malesi e Madhe” sh.a për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe noterial me qëllim transferimit të veprimtarisë ekonomike për të shoqëria e re SKP-UK qe do të krijohet.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË ASETVEVE  
SEKTORI JURIDIK

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË ASETVEVE  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1848/Prot.

Koplik, më 20/06/2022

Relacion

PËR  
“PJESËMARRJEN E BASHKISË MALËSI E MADHE NË SUBJEKTE ME  
KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË  
FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE  
TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 64 germa c dhe neni 2:

Të nderuar këshilltarë

Më lejoni tju paraqes relacionin për marrjen e autorizimit për pjesëmarrjen e Bashkisë Malësi e Madhe në marreveshjen specifike me bashkite e Qarkut Shkoder (subjekte me kompetenca të përbashkëta) me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Kjo reformë e ndërmarrë në sektorin e ujësjellës kanalizimeve ka synim dhe sfidë ristrukturimin e shoqërive, për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësve, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura si dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standartet e Bashkimit Evropian.

Agregimi i shoqërive duke krijuar shoqëri të konsoliduara me strukturë të përbashkët synon përmirësimin e efikasitetit ekonomik, akses në burimet ujore dhe menaxhim të integruar të burimeve ujore. E gjithë kjo marreveshje që mund të lidhet me bashkite të Qarkut Shkoder bazohet në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe perpunimit të ujërave të ndotura”

**Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj.**

